



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISE SE QYTETIT KORCE

VENDIM

Nr 6 datë 17/02/2011

“Mbi percaktimin e kriterëve për perzgjedhjen nëpërmjet konkurrimit të subjektit që do të kryejë transportin qytetes (urban) në të dy linjat e qytetit të Korcës, me subvencionim”.

Keshilli Bashkiak i mbledhur sot, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga ekzekutivi si dhe bazaruar në nenin 10 pika d dhe 32 pika k të ligjit nr.8562 date 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore “ në ligjin nr.8308, date 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar, në nenin 14 të si, dhe udhezimit nr.15 date 24.07.2007 të Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit” “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor “ të ndryshuar dhe mbas diskutimeve të keshilltareve

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e nevojshme mbi bazën e të cilave do të kryet perzgjedhja e shoqërisë dhe sistemin e pikezimit si më poshtë :

A. Vitin e prodhimit të automjetit. Duke u dhënë përparësi automjeteve më të reja, vlerësimi për çdo autobus të jetë:

Me vit prodhimi 1991 – 1995 = 5 pikë.

Me vit prodhimi 1996 – 2000 = 10 pikë.

Me vit prodhimi 2001 – 2005 = 15 pikë.

Me vit prodhimi 2006 – 2010 = 20 pikë.

Ndërsa autobusët me vit prodhimi deri në vitin 1990 nuk vlerësohen me pikë.

B. Numrin e autobusëve që do të përdoren në linjë. Numri minimal i autobusëve që nevojiten për të dy linjat si dhe nga sa u sqarua më sipër është 7 dhe për t'i dhënë përparësi subjektit që do të përdorë më shumë se numri i kërkuar, t'i jepen 30 pikë për çdo autobus shtesë. Gjithashtu si dhe sipër për autobusët shtesë me vit prodhimi deri në vitin 1990 nuk vlerësohen me pikë.

C. Numrin e viteve që subjekti ka ushtruar veprimtarinë në transportin e udhëtarëve me autobusë. Subjekti përfiton 10 pikë për çdo vit gjatë të cilit ka ushtruar këtë aktivitet.

2. Kontrata me subjektin fitues të lidhet me një afat 5 vjeçar , me subvencionimin vjetor , në masën 3 500 000, për të dy linjat.
3. Subvencionimi të përdoret për udhëtimin falas në shërbimin e transportit urban për moshën e tretë ,si dhe për udhëtimin me gjysmën e çmimit të biletës për studentet.
4. Sipas kriterëve të përcaktuara të kryetë perzgjedhja e subjektit të transportit, nëpërmjet konkursit të hapur .
5. Njoftimi i datës së konkurrimit, kriterëve dhe i dokumentave që duhet të paraqesin konkurrentet të kryhet nëpërmjet publikimit në media dhe në stendin e lajmerimeve të Bashkisë Korçë .
6. Data e zhvillimit të konkurrimit të jetë 10-dite pas nga data e publikimit të njoftimit .
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave .
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

KRYETARI

Gjergji PENDAVINJI

